


Trusti



FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

BULETINI TREMUJOR
NR 58 -- VITI XV -- TM2 2022

TRUSTORJA

PERFORMANCA

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-4.04%	-4.56%	-7.11%	8.19%	12.16%	59.97%
BENÇMARKU*	1.40%	3.79%	8.75%	16.90%	21.28%	61.38%

*Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit sikurse i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.

LËVIZJET MUJORE

MUAJI	NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT		KTHIMI BRUTO STANDARD (MLN)	KTHIMI BRUTO KONSERVATIV (MLN)
	STANDARD	KONSERVATIV		
Prill	-0.77%	+0.28%	€(16.82)	€0.25
Maj	+0.24%	+0.29%	€6.13	€0.26
Qershor	-4.04%	+0.28%	€(91.21)	€0.25
Tremujori	-4.56%	+0.85%	€(101.90)	€0.76

KONTRIBUIMI

	KONTRIBUTET E REJA STANDARD (MLN)	KONTRIBUTET E REJA KONSERVATIV (MLN)	LLOGARI TË REJA	LLOGARI AKTIVE
Prill	€20.70	€0.35	3,569	348,162
Maj	€19.05	€0.42	3,580	364,399
Qershor	€20.40	€0.91	3,173	376,835
Tremujori	€60.15	€1.68	8,060	363,132*

*Mesatarja tremujore

PENSIONIMET

	TË PENSIONUAR	SHUMA E TËRHEQUR
Prill	684	€4,839,263
Maj	723	€5,249,358
Qershor	1,719	€4,340,599
Tremujori	3,126	€14,429,220

PËRMBLEDHJE SHIFRASH

	FUNDI TM2 2022	FUNDI TM1 2022
ÇMIMI I AKSIONIT STANDARD	€1.5997	€1.676158
ÇMIMI I AKSIONIT KONSERVATIV	€2.0240	€2.007017
MJETET NETO NËN MENAXHIM STANDARD	€2,192,679,649	€2,353,174,911
MJETET NETO NËN MENAXHIM KONSERVATIV	€80,860,046	€82,342,138
NUMRI I LLOGARIVE GJITHSEJ	771,052	769,839
NUMRI I LLOGARIVE AKTIVE	376,835	317,803
TARIFA INVESTUESE PËR TREMUJORIN	€1,853,948	€1,824,966
TARIFA OPERACIONALE PËR TREMUJORIN	€330,234	€325,072
INVESTIMET NË KOSOVË	€629,517,505	€597,122,424
INVESTIMET JASHTË	€1,606,297,246	€1,732,712,669
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€38,636,029	€4,903,847

PLASMANET DHE PERFORMANCA NË FUND TË TM2 2022

MENAXHUESI FONDI	NUMRI ISIN / LLOJI INVESTIMIT	PLASMANET FUNDI I TM2 2022	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME
Vanguard GSIF	IE00B03HD316	€57,618,074.60	€(4,888,823.29)
Nordea 1-SRF	LU0539147214	€222,885,980.17	€(17,383,702.31)
Nordea 1-GSEF	LU0257969260	€112,611,521.63	€(4,688,316.41)
BNY Mellon RRF	IE00B504KX99	€206,614,770.32	€(8,347,742.34)
Amundi Euro Liquidity-Rated SRI	FR0007038138	€326,536,087.90	€(162,433.38)
Schroder ISF Global Sustainable Growth	LU2305367323	€1,476,785.94	€(197,943.10)
BNP Climate Impact	LU0406802768	€2,243,461.61	€(297,670.57)
AXA WF - Framlington Digital Economy	LU1694772994	€1,946,840.24	€(475,473.07)
T. Rowe - Global Technology Equity	LU1244139827	€1,340,386.29	€(630,830.75)
Amundi Global Disruptive	LU1530899811	€2,001,301.94	€(467,108.43)
Goldman Sachs Global Millennials	LU1820776075	€1,109,152.10	€(251,137.08)
Invesco QQQ UCITS	US46090E1038	€43,393,263.82	€(11,884,726.76)
Amundi MSCI Eu Qual Fact	LU1681041890	20,552,109.77	€(2,423,745.33)
SP OilGas Expl ETF	US91232N2071	€30,532,692.56	€3,961,463.39
US Infrastructure Dev ETF	US37954Y6730	€39,449,079.46	€(6,781,189.12)
US Infrastructure ETF	US46435U7138	€42,995,606.85	€(3,431,055.48)
Invesco DB Base Metals ETF	US46140H7008	€43,524,466.62	€(11,085,117.43)
iShares Global Clean Energy ETF	US4642882249	€21,744,425.15	€(1,367,089.86)
Lyxor US\$ 10Y Inflation Expectations ETF	LU1390062831	--	€3,210,547.49
Lyxor EUR 2-10Y Inflation Expectations ETF	LU1390062245	€44,445,212.48	€(504,633.77)
Vanguard Value ETF	US9229087443	€81,366,074.49	€(4,751,085.99)
Invesco KBW Bank ETF	US46138E6288	€68,873,131.43	€(11,177,716.97)
iShares Edge MSCI Europe Val. Factor ETF	IE00BQN1K901	€75,077,258.10	€(6,687,193.78)
Lyxor EURO STOXX Banks ETF	LU1829219390	€66,549,531.36	€(5,978,686.13)
SPDR S&P Oil & Gas Explor. & Prod. ETF	US78468R5569	€51,194,219.86	€(3,212,165.91)
iShares Core Dividend Growth ETF	US46434V6213	€21,334,234.66	€(1,700,107.87)
Global X Cybersecurity ETF	US37954Y3844	€18,881,576.43	€(4,245,053.81)
Thesari i Kosovës ¹⁾	Letra me vlerë të Qeverisë	€574,429,248.32	€3,205,655.96
Banka në Kosovë ¹⁾	Depozita bankare	€54,851,067.67	€219,683.12
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€37,734,765.40	€(26,594.13)
Erste Bank (Broker)	Të painvestuara	€1,061,380.13	€(5,049.21)
Të hyra të tjera	--	--	€1,318,515.00
Paraja në dorë dhe në tranzit	Të painvestuara	€77,072.21	--
GJITHSEJ		€2,274,450,779.51	€(101,136,527.32)

¹⁾ Këto janë investime me afat të caktuar maturimi.

LAJME

<p>INVESTIMET E FKPK-SË NDIKOHEN NGA LUHATJET E TREGJEVE EDHE GJATË TM2</p>	<p>Edhe në tremujorin e dytë, sikurse në tremujorin e parë, të këtij viti një varg ngjarjes me efekt negativ, duke filluar prej shkallës së lartë të inflacionit, invazionit ushtarak të Rusisë në Ukrainë me sanksionet pasuese, çmimeve shumë të larta të naftës dhe vonesave të shumta në zinxhirin furnizues, faktorë këta që kanë e çuar performancën gjashtëmujore të tregjeve financiare në nivelin më të dobët në 50 vjetët e fundit. Si pasojë e kësaj gjendjeje, edhe FKPK-ja, sikurse edhe fondet e shumta pensionale, janë prekur me rënie të vlerës së çmimit të njësisë. Më konkretisht, për portofolin Standard në FKPK kemi një rënie prej -7.0%, kurse për portofolin Konservativ kemi një kthim pozitiv prej +1.2% për periudhën janar-qershor 2022. Po ashtu, shuma e mjeteve nën menaxhim më datë 30 qershor 2022 ishte 2,283,874,879 euro, krahasuar me 2,353,171,911 euro që ishte në fundvitin 2021.</p> <p>Por për shkak të diversifikimit të mjeteve të investuara dhe uljes së riskut, gjendja aktuale e investimeve të FKPK-së në krahasim me performancën e indekseve kryesore është për disa herë më e mirë. Si shembull, për gjysmën e parë të vitit 2022 indekset në SHBA: S&P500 ra për -21% e Nasdaq ra për -30%; kurse në Gjermani DAX ra për -20%, ndërsa në Francë CAC 40 ra për -17%. Vlen përmendur këtu edhe faktin se gati pa ndonjë përjashtim, edhe instrumentet financiare të cilësuar si më të sigurtat kanë performuar negativisht, siç është rasti me performancën e bonove të shteteve me vlerësim shumë të lartë.</p> <p>Duhet theksuar se është shumë i rëndësishëm fakti se të gjithë kontribuuesit afër moshës së pensionimit (63.5+ vjeçare) janë të mbrojtur nga këto luhatje të forta, meqë mjetet e tyre janë tashmë në portofolin Konservativ, i cili (siç u sqarua më lart) ka kthim pozitiv. Kurse për kontribuuesit e tjerë, që janë më larg moshës së pensionimit, kthimi në investime është ende rreth 20% në mesatare dhe ky fakt e afirmon strategjinë dhe qëllimin afatgjatë të institucionit.</p>
<p>KONFIRMOHEN PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2021 NGA AUDITORI I JASHTËM</p>	<p>Auditori i Jashtëm (RSM Kosovo Sh.P.K) i ka audituar pasqyrat financiare të FKPK-së për vitin 2021 dhe i ka konfirmuar të njëjtat. Në opinionin e dërguar, i cili është i publikuar në Raportin Vjetor 2021, Auditori i Jashtëm ka deklaruar: "Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga FKPK në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë".</p>
<p>PUBLIKOHET RAPORTI VJETOR 2021</p>	<p>Dokumenti më i rëndësishëm i FKPK-së, raporti vjetor bashkë me pasqyrat financiare, është publikuar gjatë muajit maj në uebfaqen e institucionit. Kopje fizike të këtij raporti i janë dërguar për informim Kuvendit të Kosovës, Bankës Qendore dhe Qeverisë së Kosovës.</p> <p>Vlen kujtuar se më 2021 u bënë 20 vjet nga themelimi i FKPK-së. Janë dy dekada të transformimit nga një institucion krejt i panjohur në një shtyllë themeltare shtetërore. Tash FKPK-ja zë 31% të produktit të brendshëm bruto të Kosovës. Tutje, në fundvitin 2021 ishin 752,562 qytetarë me llogari të kursimeve pensionale në FKPK, që përbëjnë kështu 63% e krejt popullsisë në moshë të punës. Po në këta 20 vjet i kishim 18 vjet fiskale me kthim pozitiv nga investimet dhe vetëm në dy (2008 dhe 2018) me kthim negativ. Nga investimet për 20 vjet janë akumuluar 782 milionë euro kthim bruto, që janë sa 25% e të gjitha mjeteve pensionale. Raportin Vjetor 2021 mund ta gjeni në vegzën: http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/raportet-vjetore/</p>

PUBLIKON:
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Korrik 2022

AUTOR
Jeton Demi

FOTO E BALLINËS
Arë me grurë - kortezi e autorit Metush Mëziu

ADRESA
Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL & UEB
info@trusti.org | www.trusti.org

Facebook:
TrustiPensional

Youtube:
Fondi Pensional i Kosovës